



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHE

Nr. _____ Prot.

Lezhë, më ____/____/2024

Shtojca 11

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)

Data 26/06/2024

Drejtuar: Bashkimit të Operatoreve Ekonomik “FLORAL” Shpk, me Nuis J68319510L & “MALVIN” Shpk, me Nuis J76403034Q, perfaqesuar nga Operatori Ekonomik “FLORAL” Shpk, me adresë Lagjja “Beslidhja”, Rruga “Kosova”, Pallati Nr. 128, kati I-re, Lezhë.

Procedura e prokurimit/lotit: E Hapur/ Sherbime.

Numri i procedurës/referenca e Lotit: REF-06688-05-27-2024.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Sherbimi i mirembajtjes të sipërfaqeve të gjebërta dhe varrezave në qytetin e Lezhës”.

Kohëzgjatja e kontratës: 12 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “FLORAL” Shpk, me Nuis J68319510L & “MALVIN” Shpk, me Nuis J76403034Q dhe me oferte ekonomike prej 19,712,976 (nëntembdhjete milion e shtateqind e dymbdhjete mije e nenteqind e shtatedhjete e gjashte) Lek pa Tvsh,
2. Operatori Ekonomik “ARJAN – A” Shpk, me Nuis K166047090 dhe me oferte ekonomike prej 20,404,565 (njetzet milion e katerqind e kater mije e peseqind e gjashtedhjete e pese) Lek pa Tvsh,

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

- Operatori Ekonomik “ARJAN – A” Shpk, me Nuis K166047090,

Nga verifikimi i dokumentacionit në SPE rezulton se OE nuk përmbush kriteret e kerkuara në pikën 1/b, si dhe të kriteret të kerkuara në pikat 2.2.1, 2.2.2, 2.2.3, 2.3.1, 2.3.2 dhe 2.3.5, të kushteve të veçanta të kualifikimit, pasi nga verifikimi i dokumentacionit në SPE rezulton se operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion në përmbushje të këtyre kriterëve.

Sa me sipër Komisioni i Vleresimit të Ofertave mbështetur nën 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e OE “ARJAN – A” Shpk, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si përfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Operatori Ekonomik “ARJAN – A” Shpk, me Nuis K16604709O, *skualifikohet*.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimin e Operatoreve Ekonomikë “FLORAL” Shpk, me Nuis J68319510L & “MALVIN” Shpk, me Nuis J76403034Q, përfaqësuar nga Operatori Ekonomik “FLORAL” Shpk, me adresë Lagjja “Beslidhja”, Rruga “Kosova”, Pallati Nr. 128, kati I-re, Lezhe, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 19,712,976 (nëntëmbëdhjetë milion e shtatëqind e dymbëdhjetë mijë e nentëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) Lek pa Tvsh është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

KRYETARI

Pjerin NDREU
